



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1792 /14 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M
Nr. 898 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.868/2026, datë 25.06.2026 për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra , "Blerje pjesë këmbimi, vaj dhe goma", e ndarë në lote, **Loti 3** me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec.

Ankimues: Operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK, me Nipt M51624039U, Adresa:Rr. Tulla 3, Z. Kadastrale 8320, Nr.pasurie 3/1431/ND, Nj. Bashkiake nr.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Pogradec.
Adresa: Lagjja nr.2, Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

Rrethanat e çështjes

I.1. Me vendimin Nr. 868/2026, datë 25.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Skyline SC” ShPK për procedurën e prokurimit **Loti 3**, me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec.*
 2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik në lidhje me Arsyet e Skualifikimit, sipas konstatimeve të këtij vendimi.*
 3. *Autoriteti Kontraktor, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni, të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij Vendimi.*
 4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “**Skyline SC**” ShPK.*
 5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 267/32 prot., datë 30.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1792/11 prot., datë 01.07.2026, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec njofton se në zbatim të vendimit të KPP-së ka kryer rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi si dhe ka bashkangjitur shkresës, procesverbalin “Për rivlerësimin e ofertave” për procedurën e prokurimit me objekt shqyrtimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 267/32 prot., datë 30.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1792/11 prot., datë 01.07.2026, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec njofton se në zbatim të vendimit të KPP-së ka kryer rivlerësimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi, si dhe ka bashkangjitur shkresës, procesverbalin “Për rivlerësimin e ofertave” për procedurën e prokurimit me objekt shqyrtimi

II.2. Referuar shkresës sipërcituar dhe nga verifikimi i raportit të auditit për rivlerësimin e ofertave të paraqitura, Komisioni konstatoi, se Autoriteti Kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit më datë 30.06.2026 sipas konstatimeve të Vendimit të KPP-së.

II.3. Për sa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec, ka zbatuar vendimin Nr. 868/2026, datë 25.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, **Loti 3**, me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Kryetar
Ismail Shehu